



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

PROCES VERBAL

**PËR VOTIMET E PROJEKTAKTEVE LIGJORE TË PARASHIKUARA NË
SEANCËN PLENARE DATË 1 SHKURT 2021, ORA 10:00**

Kuvendi, me Urdhër nr. 6, datë 27.1.2021 të Kryetarit të Kuvendit, u mbledh në seancë plenare. Rendi i ditës përfshinte çështjet e parashikuara sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit të miratuar me mirëkuptim me vendimin nr. 1, datë 18.01.2021 të Konferencës së Kryetarëve. Seanca plenare filloi punimet me çështjet e parashikuara të cilat referuar përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit kërkojnë formën e hapur dhe të fshehtë të votimit.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe masave të distancimit të detyrueshëm votimi u organizua me fletë votimi. Konceptimi dhe përgatitja e fletëve u realizua nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën si organi përgjegjës që ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare. Në analogji me nenin 60, pika 4 të Rregullores fleta përmbante objektin e votimit si dhe alternativat e votimit “pro”, “kundër” dhe “abstenim”.

Fletët e votimit u shpërndanë gjatë seancës plenare. Deputetët shprehën vullnetin me shenjë të dallueshme dhe të qartë në kutitë përkatëse të fletëve të votimit dhe pasi nënshkruan (për votimin e hapur) i hodhën në kutitë e vendosura në vend të dukshëm në qendër të sallës së seancës plenare.


Shërbimi i Seancës Plenare, nën mbikëqyrjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën u kujdes për të zhvilluar procedurën e numërimit të votave. Për të respektuar distancimin fizik të Sekretariatit dhe Shërbimit të Seancës Plenare që u angazhua në këtë proces, numërimi i votave u krye jashtë sallës së seancës plenare por brenda godinës (zyra e mbledhjeve).

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën vijoi me procedurën e numërimit dhe vlerësimit të votave si dhe nxjerrjes së rezultatit. Pas pasqyrit të të dhënave respektive, mbi bazën e numërimit të votave, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën i përcjell drejtuesit të seancës, Kryetarit të Kuvendit rezultatet për çdo çështje.

Në bazë të fletëve të vendosura në kutitë e votimit rezulton se kanë marrë pjesë në votim 104 deputetë. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën vlerëson se kuorumi është në përputhje me nenin 78 të Kushtetutës dhe nenin 55 të Rregullores së Kuvendit.

Nga numërimi u konstatua se ishin nënshkruar dhe firmosur nga deputetë gjithsej 104 fletë votimi. Rezulton se deputeti Alban Zeneli, ishte i pranishëm gjatë punimeve por nuk mori pjesë në votim.

Kuvendi që prej shtatorit 2017 në faqen zyrtare në internet, në rubrikën “Si kanë votuar deputetët” pasqyron vullnetin e shprehur nga çdo deputet në procesin e vendimmarrjes. Çdo deputet pasi të njihet me rezultatin e votimit ka të drejtë të kërkojë sqarim apo të ankohet në Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën.



Anëtar
Adnor Shameti

Sekretar
Alket Hyseni



Anëtar
Edmond Leka



Anëtar
Arlind Çaçani

Anëtar
Enver Roshi



Projektligji
“Për azilin në Republikën e Shqipërisë”

VOTIMI NË PARIM		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
86	10	6
MIRATOHET		

VOTIMI NË TËRËSI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
87	10	6
MIRATOHET		



Projektligji

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

VOTIMI NË PARIM		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
88	9	6
MIRATOHET		

VOTIMI NË TËRËSI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
87	10	7
MIRATOHET		



Projektligji

“Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”

VOTIMI NË PARIM		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
97	5	1
MIRATOHET		

VOTIMI NË TËRËSI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
97	6	1
MIRATOHET		



Projektligji

“Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”

VOTIMI NË PARIM		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
96	7	1
MIRATOHET		

VOTIMI NË TËRËSI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
95	7	2
MIRATOHET		



Projektligji

“Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.03.2009”

VOTIMI NË PARIM		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
96	7	1
MIRATOHET		

VOTIMI NË TËRËSI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
95	7	2
MIRATOHET		



Projektvendim
“Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)”

VOTIMI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
88	9	6
MIRATOHET		



Projektvendim
“Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të
Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”

VOTIMI		
PRO	KUNDËR	ABSTENIM
83	14	8
ZOTI LORENC BAKO		
ZGJIDHET ANËTAR I AKEP-it		

